



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.8, Rr “Shenasi Dishnica”, Nr. Pasuri 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, Hyrja 1, Ap.18, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim”. “Mbikqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastruktures në qytetin e Tiranës për vitin 2019”, të ndarë në lote.

Numri i referencës së procedurës: REF-31203-07-23-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **Loti i Dytë: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i murit mbajtës në fshatin Yrshek, Tiranë”.**

Fondi limit në total: 975,492.33 (nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Fondi limit: Loti i dytë: 90,886.6 (nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve 2 (dy) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 05.08.2019, ora 11:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 30 datë 29.07.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk ; **NUIS L014220170**

Vlera e ofertës = 79,978 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. **Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk;** **NUIS L01717030C**

Vlera e ofertës = 83,895.38 (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3. **Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Derbi-E” shpk & “GB Civil Engineering” shpk**
NUIS K77916947A & L51825011V

Vlera e ofertës = 85,500 (tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk NUIS L014220170

- Operatori ekonomik ”M.A.K Studio” shpk nuk plotëson gërmën ”dh” të pikës 1 të kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: ” *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*” pasi në vërtetimin Nr. 6005.Prot, datë 02.07.2019 **nuk rezulton i shlyer detyrimi i matuaruar i energjisë elektrike për muajin Qershor.**
- Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, në lidhje me përvojën e sukseshme në realizimin e punëve të ngjashme ku citohet se: ” *Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 36,355 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit*”. Ky operator ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me objekt ”Rikonstruksion i rrugës dhe rehabilitimi fasadave të rrugës ”Mujo Ulqinaku”, për të cilën nuk është paraqitur **çertifikatën e marrjes në dorëzim**, çka bie në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2.3.1 a dhe 2.3.1 b ku citohet se:”a) *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera lidhur me zbatimin e punimeve, aktin e kolaudimit, certifikatën e marrjes në dorëzim dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar. b)Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e shërbimit, situacionet përkatëse, aktin e kolaudimit, certifikatën e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore perkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)*”.
- Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të përfshirë në licensën e shoqërisë stafin teknik si 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier mjedisi. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mësipërm kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit*” pasi për inxhinierët e deklaruar **diplomat dhe librezat e punës janë paraqitur fotokopje e pashoqëruar me Vërtetimin e Noterizimit**, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se:” *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*”
- Operatori ekonomik “M.A.K Studio” shpk nuk plotëson pikën 4.b të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen periudhën Janar 2019 – Qershor 2019 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore*”, **pasi nuk ka paraqitur formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore për periudhën e sipërcituar.**

2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Derbi-E” shpk& “GB Civil Engineering” shpk NUIS K77916947A & L51825011V

- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Derbi-E” shpk & “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë te perfshire ne licensen e shoqerise stafin teknik si 1 inxhinier ndërtimi, 1 inxhinier mjedisi. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mësipërm kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit”*, pasi për inxhinierët e deklaruar nga operatori ekonomik “Derbi E” shpk me iniciais B.D, M.R, A.Q, A.K, A.K nuk janë paraqitur **Librezat e Punës** ndërsa për inxhinierët me iniciais T.H dhe G.D nuk janë paraqitur **Diplomat Përkatëse dhe Librezat e Punës**; për inxhinierët e deklaruar nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk rezulton se për inxhinierin me iniciais A.S nuk është paraqitur **Libreza e Punës**, inxhinieri me iniciais D.O nuk është paraqitur **Libreza e Punës dhe Diploma** është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vertetimin e njëhimit të dokumentit fotokopje me atë origjinal cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* si dhe për inxhinierin me iniciais D.P nuk është paraqitur **Librez e Punës dhe CV**.
- Operatori ekonomik “Derbi-E” shpk nuk plotëson pikën 4.b të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen periudhën Janar 2019 – Qershor 2019 shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore”*, **pasi nuk ka paraqitur formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore** për periudhën e sipërcituar.
- Operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, në lidhje me përvojën e sukseshme në realizimin e punëve të ngjashme ku citohet se: *“Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 353,842 (treqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit”* pasi nga 3 kontrata të praqitura si punë e ngjyshme 2 prej tyre rezultojnë me objekt të ndryshëm nga ai që po prokurohet ndërsa për kontratën me objekt: *“Rikonstrukcion i rrugës Gora-Zagorë”* nuk është paraqitur situacioni, akti i kolaudimit dhe Çertifikata e marrjes në dorëzim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk** me adresë: Njësia Bashkiake Nr.8, Rr “Shenasi Dishnica”, Nr. Pasuri 10/221+1-18, zona kadastrale 8370, Hyrja 1, Ap.18, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **83,895.38** (tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 07.08.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.